



REPUBLIKA E KOSOVËS - REPUBLIKA KOSOVA - REPUBLIC OF KOSOVO
KËSHILLI GJYQËSOR I KOSOVËS - SUDSKI SAVET KOSOVA - KOSOVO JUDICIAL COUNCIL
PANELI ZGJEDHOR PËR ANKESA DHE PARASHTRESA
IZBORNI PANEL ZA ŽALBE I PREDSTAVKE - ELECTION COMPLAINTS AND APPEALS PANEL

ZP. Anr.35/2025

PANELI ZGJEDHOR PËR ANKESA DHE PARASHTRESA (PZAP), në panelin e përbërë nga gjyqtarët: Violeta Husaj Rugova – kryesuese, Bujar Muzaqi dhe Hajriz Hoti - anëtarë, duke vendosur lidhur me ankesën e subjektit politik Lidhja Demokratike e Kosovës (LDK), me seli në Prishtinë, parashtruar kundër subjektit politik Lëvizja Vetëvendosje (LVV), me seli në Prishtinë, për shkak të shkeljes së Kodit të Mirësjelljes për Subjektet Politike, Mbështetësit e tyre dhe Kandidatët, gjatë fushatës zgjedhore për Zgjedhjet e Parakohshme për Kuvend të Republikës së Kosovës, që do të mbahen më 28 Dhjetor 2025, në seancën e panelit të mbajtur më datë 26.12.2025, merr këtë :

V E N D I M

Refuzohet si e pabazuar ankesa e subjektit politik Lidhja Demokratike e Kosovës (LDK), me seli në Prishtinë e paraqitur kundër kandidatit për deputet për Kuvend të Republikës së Kosovës, Ejup Maqedonci nga radhët e subjektit politik Lëvizja Vetëvendosje (LVV), për shkak të shkeljes së Kodit të Mirësjelljes për Subjektet Politike, Mbështetësit e tyre dhe Kandidatët, gjatë fushatës zgjedhore për Zgjedhjet e Parakohshme për Kuvend të Republikës së Kosovës, që do të mbahen më 28 Dhjetor 2025.

A r s y e t i m

Me datë 24.12.2025 PZAP-i, ka pranuar një ankesë nga subjekti politik Lidhja Demokratike e Kosovës (LDK) me seli në Prishtinë, në të cilën pretendohet se përmes aktivistëve të saj ka vërejtur një video të kandidatit për deputet Ejup Maqedonci, i cili së bashku me kryetarin e Podujevës për qëllime zgjedhore kanë përdorur zyrën e Komunës së Podujevës, respektivisht zyrën e kryetarit për të bërë fushatë politike. Më këtë rast, parashtruesi i ankesës pretendon se me këtë veprim kandidati në fjalë dhe kryetari i Podujevës Shpejtim Bulliqi kanë shkelur nenin 36, paragrafi 1 të Ligjit Nr.08/L-228 për Zgjedhjet e Përgjithshme në Republikën e Kosovës. Bazuar në këto, ankuesi kërkon nga PZAP që ta dënoj me gjobë subjektin politik Lëvizja

Vetëvendosje (LVV). Si provë parashtruesi i ankesës ka bashkangjitur video në CD dhe linku: <https://www.facebook.com/share/p/15ZwaFLw5PL/?mibextid=wwXIfr>

Në përgjigjen në ankesë dërguar nga Lëvizja Vetëvendosje (LVV), pretendohet se ankesa e parashtruar nga LDK-ja nuk përmbush kriteret ligjore për konstatimin e një shkeljeje zgjedhore dhe se ajo mbështetet në interpretime subjektive të rrethanave dhe jo në prova konkrete që do të dëshmonin shfrytëzim të zyrës, resurseve apo pasurisë publike për qëllime të fushatës zgjedhore, siç kërkohet nga LKP-ja. Tutje, në përgjigje theksohet se prova materiale e bashkangjitur në ankesë paraqet një takim të karakterit ceremonial të Ejup Maqedonci dhe kryetarit të komunës së Podujevës Shpejtim Bulliqi, në zyrën e këtij të fundit dhe askund në video nuk paraqitet ndonjë subjekt partiak apo zgjedhor dhe nuk ka thirrje për votim në të. Pamjet e marra me kamerë nga zyra nuk mund të klasifikohen si shfrytëzim i resurseve shtetërore për qëllime të fushatës e aq më shumë që Shpejtim Bulliqi, zyra e të cilit është shfrytëzuar, nuk është kandidat në këto zgjedhje.

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa - PZAP, pasi shqyrtimit të ankesës dhe shkresave të lëndës, gjeti se:

-Ankesa është e pabazuar.

Paneli, pas shqyrtimit të shkresave të lëndës dhe përgjigjes së subjektit politik LVV ndaj ankesës, vlerëson se pretendimet e subjektit politik Lidhja Demokratike e Kosovës (LDK) janë të pabazuara dhe të paqëndrueshme. Ankesa ka kërkuar vërtetimin e shkeljes së nenit 36 të Ligjit NR.08/L-228 për Zgjedhjet e Përgjithshme në Republikën e Kosovës, i cili ndalon përdorimin e zyrës, pasurisë ose resurseve publike për qëllime të fushatës zgjedhore. Sipas ligjit, personi që mban pozitë publike nuk mund të shfrytëzojë burimet e institucioneve publike për përfitim të votave ose për mbështetje të ndonjë subjekti politik.

Megjithatë, bazuar në materialet e paraqitura nga ankuesi, përfshirë edhe videon dhe linkun e bashkëngjitur, paneli nuk gjen prova të qarta dhe bindëse që kandidati për deputet, Ejup Maqedonci, të ketë kryer shkeljen e pretenduar. Nga video rezulton se takimi është zhvilluar gjatë kohës së fushatës, por nuk përmban elementë që tregojnë promovim të subjektit politik; kryetari i komunës i referohet si ministër, dhe nuk ka prova që kandidati ka promovuar LVV-në, siç nuk shfaqen as slogane apo numër kandidati. Në mungesë të provave të qarta, ankuesi nuk ka arritur të vërtetojë se kandidati ka përdorur ambientet e Komunës së Podujevës për qëllime të fushatës zgjedhore, dhe si rrjedhojë pretendimi konsiderohet i pabazuar.

Andaj duke u mbështetur në nenin 117.3 të LKP-së ku përcaktohet se “*vendosja për ankesat nga PZAP-ja mbështetet në dëshmi të qarta dhe bindëse*”, paneli vlerësoj se pretendimet e tilla janë të pa qëndrueshme dhe si të tilla i refuzoj, për faktin se nuk ka prova që e vërtetojnë se veprimet e përshkruara në ankesë nga parashtruesi i ankesës paraqesin shkelje të dispozitave të lartcekura, barra e të provuarit bie mbi ankuesin. Andaj, paneli që ankesën ta refuzoi si të pabazuar.

Nga arsyet e theksuar më lartë duke bazuar nenin 117 paragrafi 3, neni 118 paragrafi 1 të LZP-së, paneli vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa
ZP.Anr.35/2025 datë 26.12.2025

Kryesuese e Panelit
Violeta Husaj Rugova



Këshillë Juridike: Kundër këtij vendimi është e lejuar ankesa sipas nenit 118 paragrafi 4 të Ligjin Nr.08/L-228 Për zgjedhjet e përgjithshme në Republikën e Kosovës, në Gjykata Supreme të Kosovë, brenda 48 orëve nga momenti i marrjes-pranimi të këtij vendimi.